

PERCEPTIMI NDAJ SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME NDAJ SIGURISË NË SHOQPËRI





Qendra
për Studimin
e Demokracisë
dhe Qeverisjes

Autorë:

Mirsada Hallunaj dhe Nino Strati

Metodologjia dhe koordinimi i punës në terren:

Eduard Zaloshnja

Recensimi i brendshëm:

Arjan Dyrmishi

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat e pronës intelektuale mbrohen me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjeti elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +383 38 221 420.

Të dhënat e paraqitura në këtë raport janë nga anketa e Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP). BSBP është një nismë e re rajonale e iniciuar nga QKSS në vitin 2020, e cila zbatohet në bashkëpunim me Qendrën e Beogradit për Politikën e Sigurisë (BCSP) në Serbi dhe Qendrën për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) në Shqipëri, me mbështetjen e National Endowment for Democracy (NED). BSBP shërben si një instrument për të matur perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për çështje të ndryshme lidhur me sigurinë. Të dhënat tregojnë se si qytetarët i perceptojnë apo informohen rreth çështjeve të paraqitura në këtë raport. Si të tilla, pikëpamjet e paraqitura në këtë raport nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e QKSS, BCSP, CSDG ose NED.

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën Angleze.

Financohet nga :



Konsorciumi i drejtuar nga:





PERCEPTIMI NDAJ SIGURISË PUBLIKE, KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME DHE TË JASHTME NDAJ SIGURISË NË SHQIPËRI

Dhjetor 2022

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	1
2. Perceptimi ndaj sigurisë publike	2
3. Perceptimi publik ndaj kërcënimeve të brendshme	8
4. Perceptimi publik ndaj kërcënimeve të jashtme	14
5. Përmbyllja	16

1. HYRJJE

Barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) është një projekt rajonal i zbatuar nga organizata lokale të shoqërisë civile, i cili mat perceptimet e publikut në Shqipëri, Kosovë dhe Serbi për një gamë të gjerë çështjesh të ndryshme të lidhura me sigurinë, sundimin e ligjit, drejtësinë, bashkëpunimin rajonal dhe çështje që lidhen me ndërtimin e paqes.

BSBP ka një metodologji identike në të tri vendet, duke matur njëkohësisht perceptimet e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë për të njëjtat çështje. Rezultatet e BSBP do të publikohen në katër raporte të ndryshme për secilin vend.

Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) i është bashkuar Barometrit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor (BSBP) për të dytin vit radhazi që nga viti 2021. Së bashku me Barometrin Kombëtar të Sigurisë që Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG) ka prodhuar që nga viti 2019, ky projekt ka prodhuar një mori të dhënash, të cilat janë përdorur nga një gamë e gjerë aktorësh përfshirë politikëbërësit, ekspertët e sigurisë, akademika, mediat, donatorët ndërkombëtarë, etj.

Edicioni rajonal mat jo vetëm perceptimin e qytetarëve shqiptarë ndaj institucioneve të tyre dhe çështjeve të sigurisë, por edhe perceptimet e tyre ndaj bashkëpunimit rajonal dhe konkretisht marrëdhëniet ndërmjet Shqipërisë, Kosovës dhe Serbisë. Ky raport i parë i BSBP 2022, fokusohet në sigurinë publike, kërcënimet e brendshme dhe të jashtme me të cilat përballet Shqipëria, të parë nga këndvështrimi i qytetarëve.

Raporti është prodhuar në bazë të të dhënave të mbledhura nga një anketë e bazuar në kampion rastësor të shtresëzuar prej 1120 personash në moshë madhore kryer gjatë periudhës 23 shtator-2 tetor 2022 përmes intervistave ballë për ballë.

Anketat u shpërndanë proporcionalisht në 61 bashki të Shqipërisë, duke marrë parasysh zonat rurale/urbane, gjininë dhe kuotat e moshës. Bazuar në këtë qasje të shtresëzuar kampionimi është arritur një përfaqësim i saktë gjeografik dhe demografik i popullsisë së rritur të Shqipërisë, duke ruajtur një marzh gabimi më të ulët se $\pm 2,9\%$ për kampionin e përgjithshëm.

2. PERCEPTIMI NDAJ SIGURISË PUBLIKE

Ky kapitull paraqet të gjitha rezultatet e anketës që lidhen me perceptimin e të anketuarve ndaj çështjeve të sigurisë publike.

Çështjet e sigurisë publike të cilave u referohet ky raport përfshijnë: perceptimet ndaj sigurisë vetjake si grabitjet, aksidentet, dhuna në shkolla, vrasjet, ngacmimet seksuale, diskriminimi gjinor, dhuna në familje, përdorimi i paligjshëm i armëve, përdorimi i drogës, trafikimi i qenieve njerëzore, ngacmimi në rrugë, dhuna në internet dhe perceptimet mbi kërcënimet e ndryshme ndaj komunitetit si largimi i trurit, infrastruktura e dobët, siguria e ndërtimeve, mungesa e ndriçimit publik, ndotja e ajrit dhe shërbimet shëndetësore publike.


Ashtu sikurse në rezultatet e një viti më parë, shqiptarët ndihen kryesisht të sigurtë në shtëpitë, lagjet, qytetet dhe shtetin e tyre. Shumica e të anketuarve ndihen ose kryesisht të sigurtë ose plotësisht të sigurtë në shtëpinë, lagjen, fshatin/qytetin e tyre. Përqindja e të anketuarve që ndiheshin disi të sigurt në Shqipëri ose gjatë përdorimit të internetit/hapësirës online është më e lartë se përqindja e atyre që ndihen disi të sigurt në shtëpinë, lagjen dhe fshatin/qytetin e tyre. (shih grafikun nr. 1)

GRAFIKU 1 NIVELI I TË NDJERIT I/E SIGURT NË SHTËPI/LAGJE/FSHAT, QYTET/SHTET/INTERNET, HAPËSIRËN ONLINE

NË Ç'MASË NDIHESH I/E SIGURT NË VENDET E MËPOSHTME?




SHTËPI/APARTMANTIN TËND



LAGJE



FSHAT/QYTET




SHTET





TEKSA PËRDOR HAPSIRËN NË INTERNET/ONLINE



Të anketuarit u pyetën se deri në çfarë mase i perceptonin komunitetet e tyre si të kërcënuara nga një listë sfidash të mundshme (shih grafikun nr. 2).

Largimi i trurit (83.48%), shërbimet e dobëta shëndetësore (53.61%) dhe ndotja e ajrit (51.48%) perceptohen nga të anketuarit si kërcënimet më të mëdha për komunitetet e tyre. Përkundrazi, infrastruktura e dobët (44.96%), mungesa e ndriçimit publik (40.60%) dhe mungesa e masave të sigurisë në vendet e ndërtimit dhe/ose zonat përreth (34.14%) konsiderohen si kërcënimet më të vogla.

GRAFIKU 2 FAKTORËT TË CILËT KËRCËNOJNË KOMUNITETIN

DERI NË Ç'MASË E KËRCËNOJNË KOMUNITETIN TËND ÇËSHTJET E MËPOSHTME?

LARGIMI I PROFESIONISTËVE/PUNOJËSVE TË AFTË



INFRASTRUKTUA E DOBËT (RRUGËT, ELEKTRICITETI ETJ.)



MUNGESA E NDRIÇIMIT PUBLIK NË QYTET/ FSHAT/LAGJE



MUNGESA E MASAVE TË SIGURISË NË VENDET E NDËRTIMIT DHE/OSE ZONAT PËRRETH



NDOTJA E AJRIT

S'e di/ S'kam opinion	0.19%
S'ka kërcënim fare	7.63%
Kërcënim i ulët	14.08%
Një farë kërcënimi	26.61%
Kërcënim	35.14%
Kërcënim i lartë	16.34%



SHËRBIME TË DOBËTA SHËNDETSORE PUBLIKE

S'e di/ S'kam opinion	0.19%
S'ka kërcënim fare	6.88%
Kërcënim i ulët	13.02%
Një farë kërcënimi	26.30%
Kërcënim	34.26%
Kërcënim i lartë	19.35%



Gjysma e të anketuarve (50.40%) mendojnë se Policia e Shtetit dhe Gjyqësori kanë kapacitete deri në një masë të caktuar për t'u marrë me kërcënimet e ndryshme ndaj sigurisë kombëtare. Ndërkohë, 26.22% e të anketuarve mendojnë se Policia e Shtetit dhe Gjyqësori kanë kapacitete të plota dhe 21.90% mendojnë se këto institucione nuk kanë kapacitete të mjaftueshme për t'u përballur me kërcënimet e sigurisë së komunitetit. Një numër i konsiderueshëm i të anketuarve (65.73%) mendojnë se Policia e Shtetit ka kontribuar vetëm pjesërisht në përmirësimin e sigurisë së komunitetit përgjatë 12 muajve të fundit.

GRAFIKU 3 KAPACITETET E POLICISË SË SHETITIT DHE GJYQËSORIT PËR TË ADRESUAR KËRCËNIMET NDAJ SIGURISË SË KOMUNITETIT

A MENDON SE POLICIA E SHETITIT DHE GJYQËSORI KANË KAPACITETET E DUHURA PËR TË TRAJTUAR KËRCËNIMET E SIGURISË NË KOMUNITET?

S'e di/ S'kam opinion	1.48%
Po	26.22%
Deri diku	50.40%
Jo	21.90%



GRAFIKU 4 KONTRIBUTI I POLICISË SË SHETITIT NË PËRMIRËSIMIN E SIGURISË SË KOMUNITETIT

A KA KONTRIBUAR POLICIA E SHETITIT NË PËRMIRËSIMIN E SIGURISË SË KOMUNITETIT TUJ NË 12 MUAJT E FUNDIT?

S'e di/ S'kam opinion	1.09%
Në mënyrë thelbësore	7.49%
Pjesërisht	65.73%
Policia është e paefektshme në trajtimin e çështjeve të sigurisë publike	25.69%



Duke patur parasysh zhvillimet më të fundit globale, përfshirë luftën në Ukrainë dhe krizën energjetike, shqiptarët u pyetën nëse ndihen të shqetësuar për mungesën e disa mallrave të nevojshme. Mungesa e ngrohjes (63.97%) dhe karburantit (60.07%) perceptohen si shqetësimet më të mëdha nga shqiptarët.


Ndërsa mungesa e ilaçeve (45.39%), energjisë elektrike (46.02%) dhe e ushqimit (46.26%) sjellin më pak shqetësime për shqiptarët, por gjithsesi pothuajse 1 në 2 prej tyre është i shqetësuar për këto mungesa.

GRAFIKU 5 NIVELI I SHOETËSIMIT NË LIDHJE ME MUNGESAT NË: USHQIME/ILAJE/ELEKTRICITET/KARBURANT/NGROHJE


NË NJË SHKALLË NGA 1 (JO I SHOETËSUAR) NË 5 (SHUMË I SHOETËSUAR), DERI NË Ç'MASË JE I/E SHOETËSUAR PËR MUNGESAT NË?




USHQIME




ILAJE




ELEKTRICITET



KARBURANT



NGROHJE



Të anketuarit u pyetën se çfarë ata perceptonin si kërcënimin kryesor për sigurinë e tyre vetjake. (shih grafikun nr.6)

Përdorimi i drogës (58.64%) konsiderohet nga të anketuarit si kërcënimi më i lartë për sigurinë vetjake dhe zotërimi i paligjshëm i armëve (56.65%) si kërcënimi i dytë më i madh për sigurinë e tyre vetjake. Gjithashtu, më shumë se gjysma e të anketuarve i konsiderojnë vrasjet (54.92%) dhe aksidentet rrugore (53.71%) si kërcënim për sigurinë e tyre vetjake.

35.81% e të anketuarve i konsiderojnë grabitjet e shtëpive/apartamenteve si një kërcënim i ulët ose aspak kërcënim për sigurinë e tyre vetjake.

43.29% e të anketuarve i konsiderojnë ngacmimet seksuale si një kërcënim i ulët ose aspak kërcënim për sigurinë e tyre vetjake. Nuk vërehen dallime të mëdha midis të anketuarve meshkuj dhe femra. Por më shumë (10%) e të anketuarve të rinj (18-49) e konsiderojnë ngacmimin seksual si një kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë e tyre vetjake në krahasim me të moshuarit (50+).

45.7% e të anketuarve e konsiderojnë dhunën në shkolla si një kërcënim i ulët ose aspak kërcënim për sigurinë e tyre vetjake, por 10% e të anketuarve me një diplomë universitare e konsiderojnë dhunën në shkolla si një kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë e tyre vetjake krahasimisht me ata pa diplomë universitare.

47.31% e të anketuarve e konsiderojnë diskriminimin gjinor si një kërcënim i ulët ose aspak kërcënim për sigurinë e tyre vetjake. Nuk vërehen dallime midis të anketuarve meshkuj dhe femra. Por më shumë (10%) e të anketuarve të rinj (18-49) e konsiderojnë diskriminimin gjinor si një kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë e tyre vetjake në krahasim me të moshuarit (50+).

23,68% e të anketuarve e konsiderojnë dhunën në internet si një kërcënim i ulët ose aspak kërcënim për sigurinë e tyre personale. Ndërsa 34.17% e të anketuarve e konsiderojnë dhunën online si deri diku kërcënues për sigurinë e tyre vetjake.

Ky kapitull paraqiti rezultatet e anketës që lidhen me me çështjet e sigurisë publike dhe vetjake në Shqipëri. Kapitulli në vijim paraqet rezultatet e anketës rreth perceptimit të publikut ndaj kërcënimeve të brendshme në vend.

GRAFIKU 6 FAKTORËT TË CILËT KËRCËNOJNË SIGURINË VETJAKE

DERI NË Ç'MASË DUKURITË E MËPOSHTME KËRCËNOJNË SIGURINË TËNDE PERSONALE?

VJEDHJE PRONASH/GRABITJE

S'e di/ S'kam opinion	0.40%
S'ka kërcënim fare	12.97%
Kërcënim i ulët	22.84%
Një farë kërcënimi	27.60%
Kërcënim	24.47%
Kërcënim i lartë	11.72%



AKSIDENTE TRAFIKU

S'e di/ S'kam opinion	0.48%
S'ka kërcënim fare	7.04%
Kërcënim i ulët	12.45%
Një farë kërcënimi	26.32%
Kërcënim	34.57%
Kërcënim i lartë	19.14%



DHUNA NË SHKOLLA (MES NXËNËSVE)

S'e di/ S'kam opinion	3.24%
S'ka kërcënim fare	15.72%
Kërcënim i ulët	29.98%
Një farë kërcënimi	21.83%
Kërcënim	19.27%
Kërcënim i lartë	9.96%



VRASJET

S'e di/ S'kam opinion	0.08%
S'ka kërcënim fare	10.88%
Kërcënim i ulët	14.12%
Një farë kërcënimi	20.01%
Kërcënim	32.12%
Kërcënim i lartë	22.80%



NGACIMI SEKSUAL/PËRDHUNIMI

S'e di/ S'kam opinion	1.67%
S'ka kërcënim fare	20.25%
Kërcënim i ulët	23.04%
Një farë kërcënimi	19.58%
Kërcënim	19.28%
Kërcënim i lartë	16.18%



DISKRIMINIMI GJINOR

S'e di/ S'kam opinion	2.42%
S'ka kërcënim fare	21.22%
Kërcënim i ulët	26.09%
Një farë kërcënimi	22.38%
Kërcënim	17.76%
Kërcënim i lartë	10.12%



DHUNA NË FAMILJE

S'e di/ S'kam opinion	0.56%
S'ka kërcënim fare	18.59%
Kërcënim i ulët	24.72%
Një farë kërcënimi	21.37%
Kërcënim	20.63%
Kërcënim i lartë	14.14%



ZOTËRIMI I PALIGJSHËM I ARMËVE

S'e di/ S'kam opinion	0.54%
S'ka kërcënim fare	10.05%
Kërcënim i ulët	13.20%
Një farë kërcënimi	19.56%
Kërcënim	34.59%
Kërcënim i lartë	22.06%



PËRDORIMI I DROGËS DHE VARËSIA NGA DROGA

S'e di/ S'kam opinion	0.89%
S'ka kërcënim fare	8.17%
Kërcënim i ulët	14.49%
Një farë kërcënimi	17.80%
Kërcënim	31.91%
Kërcënim i lartë	26.73%



TRAFIKIMI I QENIEVE NJERËZORE

S'e di/ S'kam opinion	0.74%
S'ka kërcënim fare	15.23%
Kërcënim i ulët	22.09%
Një farë kërcënimi	23.57%
Kërcënim	21.75%
Kërcënim i lartë	16.62%



NGACIMET NË RRUGË

S'e di/ S'kam opinion	0.54%
S'ka kërcënim fare	22.99%
Kërcënim i ulët	27.11%
Një farë kërcënimi	25.52%
Kërcënim	15.40%
Kërcënim i lartë	8.45%



DHUNA ONLINE

S'e di/ S'kam opinion	5.11%
S'ka kërcënim fare	6.91%
Kërcënim i ulët	16.77%
Një farë kërcënimi	34.17%
Kërcënim	25.41%
Kërcënim i lartë	11.63%



3. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ KËRCËNIMEVE TË BRENDSHME

Ky kapitull paraqet të gjitha rezultatet e anketës që lidhen me perceptimet e publikut ndaj kërcënimeve të brendshme.

Kërcënimet e brendshme të cilave u referohet ky raport përfshijnë korrupsionin, krimin e organizuar, trafikun e paligjshëm të armëve, trafikun e drogës, papunësinë, pandeminë COVID-19, ekstremizmin e dhunshëm dhe terrorizmin, ikjen e trurit, krizën ekonomike dhe lajmet e rreme.

Kriza ekonomike (88.82%) konsiderohet si kërcënim i parë për sigurinë kombëtare nga shqiptarët. Ndërsa krimi i organizuar (83.3%), ikja e trurit (82.88%), papunësia (81.32%) dhe korrupsioni (79.91%) konsiderohen gjithashtu si kërcënime të brendshme të larta për sigurinë kombëtare të Shqipërisë.

Në të kundërt, pandemia COVID-19 (21.43%) lajmet e rreme (51.95%) dhe ekstremizmi i dhunshëm (56.98%) konsiderohen si kërcënimet më pak të larta për sigurinë kombëtare të vendit (shih grafikun nr. 7).

Grafiku 8 paraqet në mënyrë krahasimore kërcënimet e brendshme ndaj sigurisë kombëtare gjatë viteve 2021 dhe 2022, ku vërehet një rritje pothuajse e dyfishuar për sa i përket korrupsionit dhe krimin të organizuar si kërcënime të brendshme për sigurinë kombëtare të Shqipërisë. Gjithashtu, ka një rritje prej mbi 25% të të anketuarve që mendojnë se trafikimi i armëve dhe drogës përbën një kërcënim për sigurinë kombëtare në krahasim me vitin 2021.

Nga ana tjetër, Covid-19 konsiderohet nga të anketuarit si një kërcënim më i ulët (21.43%) për sigurinë kombëtare duke e krahasuar me vitin e kaluar (39.34%). Duke marrë parasysh kategoritë e ndryshme, vlen të theksohet se ata me arsim të lartë e konsiderojnë papunësinë dhe ekstremizmin e dhunshëm si kërcënim për sigurinë kombëtare më shumë se ata pa arsim të lartë (12%+).

GRAFIKU 7 KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË SHQIPËRISË
SI I VLERËSONI KËRCËNIMET E BRENDSHME TË MËPOSHTME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE NË SHQIPËRI?



TRAFIKIMI I PALIGJSHËM I ARMËVE

S'e di/ S'kam opinion	1.25%
S'ka kërcënim fare	6.75%
Kërcënim i ulët	6.33%
Një farë kërcënimi	16.67%
Kërcënim	41.70%
Kërcënim i lartë	27.30%



TRAFIKIMI I PALIGJSHËM I DROGËS

S'e di/ S'kam opinion	0.54%
S'ka kërcënim fare	4.59%
Kërcënim i ulët	6.13%
Një farë kërcënimi	15.51%
Kërcënim	36.64%
Kërcënim i lartë	36.59%



PAPUNËSIA

S'e di/ S'kam opinion	0.14%
S'ka kërcënim fare	1.77%
Kërcënim i ulët	3.68%
Një farë kërcënimi	13.10%
Kërcënim	30.62%
Kërcënim i lartë	50.70%



GJENDJA E PANDEMISË COVID-19

S'e di/ S'kam opinion	0.08%
S'ka kërcënim fare	20.75%
Kërcënim i ulët	33.91%
Një farë kërcënimi	23.82%
Kërcënim	14.35%
Kërcënim i lartë	7.08%




EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE TERRORIZMI

S'e di/ S'kam opinion	1.12%
S'ka kërcënim fare	8.54%
Kërcënim i ulët	10.88%
Një farë kërcënimi	22.47%
Kërcënim	33.72%
Kërcënim i lartë	23.26%



QYTETARËT QË EMIGROJNË JASHTË SHOIPËRISË

S'e di/ S'kam opinion	0.24%
S'ka kërcënim fare	2.57%
Kërcënim i ulët	3.28%
Një farë kërcënimi	11.03%
Kërcënim	31%
Kërcënim i lartë	51.88%



KRIZA EKONOMIKE

S'e di/ S'kam opinion	0.08%
S'ka kërcënim fare	0.35%
Kërcënim i ulët	1.79%
Një farë kërcënimi	8.95%
Kërcënim	33.61%
Kërcënim i lartë	55.21%




LAJMET E RREME

S'e di/ S'kam opinion	0.78%
S'ka kërcënim fare	2.54%
Kërcënim i ulët	12.05%
Një farë kërcënimi	32.68%
Kërcënim	34.73%
Kërcënim i lartë	17.22%



GRAFIKU 8 KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË SHOQPËRISË MË 2021 DHE 2022



**KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË
KOMBËTARE MË 2021**



TRAFIKIMI I DROGËS




PAPUNËSIA



COVID-19




**EKSTREMIZMI I DHUNSHËM
DHE TERRORIZMI**



**KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË
KOMBËTARE MË 2022**



TRAFIKIMI I DROGËS



PAPUNËSIA



COVID-19




**EKSTREMIZMI I DHUNSHËM
DHE TERRORIZMI**




**KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË
KOMBËTARE MË 2021**



IKJA E TRURIT



KRIZA EKONOMIKE




LAJMET E RREME




**KËRCËNIMET E BRENDSHME NDAJ SIGURISË
KOMBËTARE MË 2022**



IKJA E TRURIT



KRIZA EKONOMIKE



LAJMET E RREME




Lidhur me perceptimet e të anketuarve për efektivitetin e vaksinave për ndalimin e pandemisë Covid-19, pothuajse gjysma e tyre mendojnë se vaksinat kanë kontribuar deri në një farë mase në ndalimin e pandemisë. (shih grafikun nr.9)

Ata që nuk ishin ende të vaksinuar, u përgjigjën se nuk janë vaksinuar, kryesisht për shkak të mungesës së besimit ndaj vaksinave kundër COVID-19, për shkak të besimit të tyre në imunitetin natyror pas infektimit dhe mungesës së besimit vaksinat e disponueshme në Shqipëri.


GRAFIKU 9 COVID-19 SI NJË KËRCËNIM PËR SHËNDETIN VETJAK & EFEKTSHMËRIA E VAKSINIMIT KUNDËR COVID-19 PËR TË NDALUAR APO FRENUAR PANDEMINË

A BESONI SE COVID-19 VAZHDON TË RREZIKOJË SHËNDETIN TUAJ DHE SE VAKSINIMI KUNDËR COVID-19 KA KONTRIBUAR PËR TË NDALUAR APO FRENUAR PANDEMINË?

A BESONI SE COVID-19 VAZHDON TË RREZIKOJË SHËNDETIN TËND?



A KONTRIBUOI VAKSINIMI KUNDËR COVID-19 NË NDALIMIN APO FRENIMIN E PANDEMISSË?



Kapitulli i mësipërm paraqiti rezultatet e anketës që lidhen me kërcënimet e brendshme ndaj Shqipërisë. Kapitulli i mëposhtëm paraqet rezultatet e anketës që lidhen me kërcënimet e jashtme ndaj Shqipërisë.

4. PERCEPTIMI PUBLIK NDAJ KËRCËNIMEVE TË JASHTME

Të anketuarit u pyetën në lidhje me kërcënimet e jashtme ndaj Shqipërisë.

Kërcënimet e jashtme të cilave u referohet ky raport përfshijnë ndryshimet klimatike dhe ndotjen e ajrit, çështjet e sigurisë kibernetike, luftën në Ukrainë, përshkallëzimin e çështjeve rajonale, rritjen e çmimeve dhe krizën energjitike.

Rritja e çmimit të produkteve të ndryshme konsiderohet nga 83.85% e të anketuarve si kërcënim kryesor i jashtëm ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë. Pas ngjarjeve të fundit, 75.05% e të anketuarve i konsiderojnë çështjet e sigurisë kibernetike si kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë kombëtare, një shifër shumë më e lartë se perceptimi në vitin 2021 (39.08%).

Kriza energjetike konsiderohet si kërcënim ose kërcënim i lartë nga 73.21% e të anketuarve. Më shumë se gjysma e të anketuarve e konsiderojnë luftën në Ukrainë (58.89%) dhe ndryshimet klimatike (54.94%) si një kërcënim ose kërcënim të lartë për sigurinë kombëtare.


Krahasuar me vitin e kaluar ku 33.12% e të anketuarve i konsiderojnë ndryshimet klimatike dhe ndotjen si kërcënim apo kërcënim të lartë, këtë vit një numër më i madh i të anketuarve (53.94%) e konsiderojnë atë si kërcënim apo kërcënim të lartë për sigurinë kombëtare.

Ndërsa përshkallëzimi i çështjeve rajonale (45.15%) konsiderohet si kërcënim i jashtëm më pak i rëndësishëm për sigurinë kombëtare të vendit.

Ky kapitull paraqiti perceptimet e qytetarëve ndaj kërcënimeve të jashtme në vend.


GRAFIKU 10 KËRCËNIMET E JASHTME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË SHQIPËRISË

SI I VLERËSONI KËRCËNIMET E JASHTME TË MËPOSHTME NDAJ SIGURISË KOMBËTARE?





LUFTA NË UKRAINË



MUNDËSIA E PËRSHKALLËZIMEVE NË RAJON



RRITJA E ÇMIMEVE TË PRODUKTEVE TË NDRYSHME



KRIZA ENERGETIKE



5. PËRMBYLLJA

Ky raport është përgatitur me qëllim për të shqyrtuar perceptimin e qytetarëve shqiptarë ndaj çështjeve të sigurisë publike dhe vetjake, kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme.

Për shkak të zhvillimit të vazhdueshëm të teknologjisë dhe shtimit të aktiviteteve të rrezikshme online, edhe pse shumica e qytetarëve ndihen të sigurtë në hapësirën e tyre online, 1 në 5 shqiptarë ndihet i pasigurtë gjatë përdorimit të internetit. Shumica dërrmuese e shqiptarëve ndihen të sigurtë në shtëpinë, lagjen ose në fshatin/qytetin e tyre. Megjithëse shumica ndihen të sigurtë në Shqipëri, vërehet një tendencë në rritje e pasigurisë krahasuar me jetesën në shtëpi ose në komunitetin e tyre.

Qytetarët e konsiderojnë ikjen e trurit, shërbimet e dobëta shëndetësore publike dhe ndotjen e ajrit si kërcënimet më të larta për komunitetet e tyre. Në të kundërt, infrastruktura e dobët, mungesa e ndriçimit publik dhe mungesa e masave të sigurisë në vendet e ndërtimit dhe/ose zonat përreth konsiderohen si kërcënimet më të ulta. Përdorimi i drogës, mbajtja e armëve pa leje, vrasjet dhe aksidentet në trafik janë identifikuar si kërcënimet më të larta për sigurinë e tyre personale, ndërsa dhuna në shkolla, diskriminimi gjinor dhe ngacmimi në rrugë konsiderohen si kërcënimet më të ulëta.

Gjatë vitit 2022, një sërë ngjarjesh globale, duke përfshirë agresionin rus në Ukrainë, kriza energjetike dhe inflacioni kanë ndikuar në jetën e përditshme, duke shkaktuar edhe pasiguri për paqen dhe rendin global. Si rrjedhojë, qytetarët shqiptarë e shohin në vitin 2022 krizën ekonomike si kërcënimin më të madh për sigurinë kombëtare. Megjithatë, kërcënimet si krimi i organizuar, ikja e trurit, papunësia dhe korrupsioni vazhdojnë të shihen si kërcënimet kryesore nga mbi 80% e qytetarëve. Pandemia e COVID-19 konsiderohet si kërcënimi më pak i rëndësishëm për sigurinë kombëtare të vendit.

Këto të dhëna çojnë në përfundimin se edhe pse një numër më i madh qytetarësh i shohin zhvillimet e jashtme si më kërcënuese për sigurinë e tyre, kërcënimet e brendshme si korrupsioni, krimi i organizuar, papunësia etj. vazhdojnë të mbeten thelbësore në formësimin e pikëpamjeve për çështjet e sigurisë vetjake dhe kombëtare nga shqiptarët. Klima e polarizuar politike, mungesa e rezultateve konkrete nga reforma në drejtësi, i bëjnë kërcënimet e brendshme më të rëndësishme.

Për sa i përket kërcënimeve të jashtme ndaj sigurisë kombëtare të Shqipërisë, tre kërcënimet kryesore të jashtme të identifikuara janë rritja e çmimeve, kërcënimet kibernetike dhe krizat energjetike. Më shumë qytetarë i konsiderojnë sulmet kibernetike si kërcënuese për sigurinë kombëtare dhe të komunitetit sesa një vit më parë. Në përgjithësi, ka një ndryshim të dukshëm në perceptimin e të anketuarve për kërcënimet e brendshme ndaj sigurisë kombëtare nga viti 2021 deri në vitin 2022.

Katalogimi në botim **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - "Pjetër Bogdani"

Katalogimi në botim (CIP)

Biblioteka Kombëtare e Kosovës - Pjetër Bogdani

303.425.6:343.296(496.5)(047)"2022"

Hallunaj, Mirsada

Perceptimi ndaj sigurisë publike, kërcënimeve të brendshme dhe të jashtme ndaj sigurisë në Shqipëri : barometri i Sigurisë në Ballkanin Perëndimor 2022 / Mirsada Hallunaj, Nino Strati. - Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2022. - 19 f. ; 24 cm.

Kundravajtjet ndaj sigurisë publike -- Testet e opinionit publik -- Shqipëri -- Raporte -- 2022

ISBN 978-9951-799-72-0

Aleph [000105360]



ISBN 978-9951-799-72-0



9 789951 799720